




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION



**UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN
E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

Prishtinë, 15 Dhjetor 2024

Dispozitat e përgjithshme

1. Qëllimi dhe Fushëveprimi i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik

1.1 Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik është nxjerrë në pajtim me Nenin 87.2.4 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92 (këtu e tutje LPP), dhe ka për qëllim të udhëzoj të gjitha palët në zhvillimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit.

1.2 Ky udhëzues do të zbatohet nga Autoritetet Kontraktuese, personat fizik dhe Operatorët Ekonomik siç janë të përkufizuar në nenin 4, paragrafi 1, të LPP-së.

1.3 Sipas LPP lista në vijim e AK-se është thjeshtëzuar dhe i referohet grupeve në terme të përgjithshme:

Autoritetet Kontraktuese:

1. Autoritetet Publike

- a. Autoritetet qendrore dhe lokale (ministritë, komunat, etj)
- b. “Organet e themeluara në bazë të së drejtës publike” siç përkufizohet me Ligj, që nënkupton organet nën ndikim dominues publik;

2. Operatorët e Shërbimeve Publike

- a. Autoritetet publike ose ndërmarrjet publike të angazhuara në aktivitete të shërbimit publik;
- b. Entitetet tjera që kanë të drejta ekskluzive për kryerjen e shërbimeve publike (nuk është as autoritete publik as ndërmarrje publike)

3. Ndërmarrje Publike

- a. Çdo ndërmarrje nën ndikim dominues publik
4. Çdo person, komision ose kompani private që funksionon në baza të një të drejte të veçantë apo ekskluzive
5. Çdokush që kryen aktivitete të prokurimit në emër të autoriteteve të mësipërme.

2. Operimi me sistem të prokurimit elektronik

- 2.1 Gjatë përgaditjes dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit elektronik, zyrtarët e prokurimit të autoriteteve kontraktuese, përveç udhëzimeve në manualët për AK-se gjithmonë duhet të ndjekin udhëzimet e dhëna në hapat përkatës të procedurës së prokurimit.
- 2.2 Ashtu siç është përcaktuar klasifikimi i kontratave me RRPP, zyrtarët e prokurimit të AK-se obligohen që të gjitha dokumentet e aktivitetit të prokurimit të përgaditen dhe krijohen në gjuhët obligative, prandaj gjithmonë udhëzohen që të dhënat në hapat përkatës të procedurës të plotësohen për të gjitha gjuhët e përzgjedhura, sidomos për të dhënat obligative.
- 2.3 Krijimi i dokumenteve të një procedure të prokurimit në gjuhët e përzgjedhura (Dosja e tenderit, Përshkrimi i çmimeve, formularët: B04, B05, B06, B08, B10, B11, B12, B52, B54) është i suksesshëm vetëm nëse të dhënat obligative janë plotësuar për të gjitha gjuhët e përzgjedhura, prandaj nëse një dokument nuk krijohet në gjuhën e përzgjedhur, atëherë zyrtari i prokurimit duhet të kontrolloj futjen e të dhënave për secilën gjuhë dhe secilin hap.
- 2.4 Gjatë përgaditjes dhe zhvillimit të të gjitha llojeve të procedurave të prokurimit, konkurseve të projektimit, përfshirë procedurat e shitjes dhe korrigjimit të procedurës me status “në apel”, zyrtari i prokurimit është i obliguar dhe duhet të krijoj dy çelësa privat (1 dhe 2) për procedurë (të cilët i dërgohen zyrtarëve të përzgjedhur), por gjithmonë kur është e mundur zyrtarët e prokurimit udhëzohen të krijojnë edhe çelësat privat zëvendësues (3 dhe 4) të cilët për çdo rast mund të përdoren si zëvendësim gjatë procesit të hapjes dhe dekriptimit të ofertave. Në rast të tillë kombinimi zëvendësues është 1-3 dhe 2-4.
- 2.5 Përjashtim nga paragrafi paraprak janë procedurat me vlerë minimale ku nga zyrtari i prokurimit kërkohet që çelësat privat të procedurës të krijohen vetem për dekriptim të ofertave, meqenëse nuk kërkohen për t'u ngarkuar gjatë procesit të hapjes dhe hapja kryhet vetëm nga një zyrtar i prokurimit ashtu siç është specifikuar në RRPP, Neni 52, paragrafi 52.7. Procesverbali i krijuar nga hapja e ofertave të procedurës me vlerë minimale mund të përdoret nga zyrtari i prokurimit si raport i vlerësimit meqenëse përmban të gjitha të dhënat e kërkuara, emrat dhe adresën e Operatorëve ekonomik të kontaktuar si dhe çmimet e ofruara. Nëse krijohet raport i veçantë i vlerësimit, atëherë zyrtari i prokurimit udhëzohet që raportin e krijuar (jashtë sistemit të prokurimit elektronik) t'a ngarkoj si dokument tek “publikimi i B58”.
- 2.6 Gjatë përgaditjes dhe publikimit të njoftimeve (B05, B06, B08, B10, B11, B52, B54) në një procedurë të prokurimit, zyrtari i prokurimit duhet të bëjë llogaritjen e afateve kohore duke u bazuar në datën e publikimit të njoftimit dhe jo në datën e dërgimit për publikim.
- 2.7 Ashtu siç është përcaktuar në RRPP, paragrafi 24.7, “Njoftimi për informata shtesë ose përmirësim gabime (B54)”, përdoret për ndryshim ose përmirësim të Dosjes së Tenderit, Listës së çmimeve, të dhënave në njoftim për kontratë dhe zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, atëherë, zyrtari i prokurimit udhëzohet që gjatë përgaditjes dhe publikimit të formularit B54 të plotësoj vetëm të dhënat e nevojshme varësisht nga qëllimi. P.sh:
- a) nëse korrigjimi ka të bëjë me DT dhe të dhënave në Njoftim për kontratë atëherë ndryshohet/plotësohet vetëm pjesa tekstuale e cila duhet të ndryshohet në të dy dokumentet.

- b) Nëse korrighjimi ka të bëjë me Listën e çmimeve, atëherë Lista e çmimeve e ndryshuar ngarkohet tek pjesa e listës së çmimeve, ndërsa në formularin B54 tek pjesa “informacionet shitesë” vetëm specifikohet qëllimi i publikimit të korrighjimit (ndryshimi i listës së çmimeve).
- c) Nëse qëllimi i publikimit të korrighjimit ka të bëjë vetëm me zgjatje/ndryshim të datës për Mbyllje/ Afatit për dorëzimin e ofertave- kërkesës për pjesëmarrje, atëherë zyrtarët e prokurimit të AK-ë udhëzohen që:
1. ndryshimi i datave të bëhet vetëm në hapat 8. *Informacionet administrative*, dhe 10. *Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit*;
 2. hapat e tjerë në procedurë për çfarëdo ndryshimi/korrighjimi tjetër përdoren në pajtim me instruksionet në secilin hap (p.sh hapat për ndryshime tekstuale udhëzohet të fshihen nëse nuk ka tekst për t’u ndryshuar)
 3. Pas krijimit të formularit B54, formulari duhet të kontrollohet nëse të gjitha të dhënat e shënuara në hapat paraprak janë paraqitur në mënyrë korrekte dhe nëse po, atëherë njoftimi B54 dërgohet për publikim.
 4. Pas dërgimit për publikim dhe publikimit të “Formularit standard për korrighjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara (B54)” të verifikojnë në sistem të prokurimit elektronik nëse me publikimin e formularit B54 (i cili publikohet ditën e nesërme pas dërgimit për publikim) janë ndryshuar edhe datat/afatet për dorëzimin e ofertave, ndryshim i cili është i mundur vetëm nëse ndryshimi i datave është bërë në pajtim me pikat 1 dhe 2 më lartë.
- 2.8 Zgjatja/ndryshimi i datës për Mbyllje/ Afatit për dorëzimin e ofertave në procedurë të kufizuar, konkurruese me negociata (faza e dytë), të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe mini-tender, bëhet nëpërmjet ri-krijimit dhe ri-dërgimit të ftesave të OE pjesëmarrës.
- 2.9 Gjatë përgaditjes dhe dërgimit të “Kërkesave për rishqyrtim” në AK dhe përgaditjes dhe dërgimit të “Ankesave” në OSHP, OE udhëzohen gjithmonë që “Kërkesa për rishqyrtim” dhe “Ankesa” të përgatitet dhe dërgohet para skadimit të afatit të fundit për parashtrim kërkesës për rishqyrtim/ankesës. Ky udhëzim është i rëndësishëm të ndjeket nga OE sepse ashtu siç është specifikuar në RRPP, nëse parashtruesi dështon të përgatitë dhe paraqesë kërkesën për rishqyrtim/ankesën brenda afateve kohore për arsye të çfarëdo problemi teknik që ndodhë në dy (2) orët e fundit para skadimit të afatit të fundit për paraqitje të kërkesës/ankesës, përgjegjësia e dështimit mbetet tek parashtruesi (OE).
- 2.10 Në rastin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit të ndarë në LOT-e, dhe nëse AK ka për qëllim apo duhet që për secilin LOT të krijoj kontratë të veçantë, atëherë ZPP këshillohet që ndarjen e LOT-ve në kontrata të veçanta t’a bëjë gjatë përgaditjes së “Njoftimit për dhënie të kontratës (B08)” – ku në hapin përkatës (5) duhet të krijoj një numër të kontratës për secilin LOT dhe më pastaj një kontratë e tillë trajtohet njëjtë si kontratë e veçantë në të gjitha fazat në vijim, krijimi i draftit të kontratës, Njoftimit për nënshkrim të kontratës dhe menaxhimi i kontratës gjithashtu.

3. Klasifikimi i kontratave publike sipas vlerës

3.1 Bazuar në vlerën e parashikuar të kontratës, kontratat klasifikohen në katër lloje të ndryshme të kontratave:

- a. *“kontratë me vlerë të madhe”;*
- b. *“kontratë me vlerë të mesme”;*
- c. *“kontratë me vlerë të vogël” dhe*
- d. *“kontratë me vlerë minimale*

3.2 Pragjet e vendosura për aktivitete të ndryshme të prokurimit janë si në vijim:

VLERA E PARASHIKUAR	FURNIZIM	SHËRBIME	KONKURS PËR PROJEKTIM		PUNË
			<i>Dhënia e kontratës për shërbime</i>	<i>Shpërblime dhe pagesa për pjesëmarrësit</i>	
VLERË TË MADHE	≥ 125,000 €		≥ 125,000 €	≥ 100,000 €	≥ 500,000 €
VLERË TË MESME	< 125,000 € ≥ 10,000 €		< 125,000 € ≥ 10,000 €	< 100,000 € ≥ 10,000 €	< 500,000 € ≥ 10,000 €
VLERË TË VOGËL	< 10,000 € ≥ 1,000 €		< 10,000 €		< 10,000 € ≥ 1,000 €
VLERË MINIMALE	< 1,000 €		*		< 1,000 €

3.3 Secili aktivitet i prokurimit duhet të ketë një Numër të Prokurimit, i cili krijohet në përputhje me nenin 15 të Rregullores për Prokurimin Publik. *(shih Aneks 1, bashkëngjitur këtij Udhëzuesi).*

3.4 Kontratat publike përfshijnë çdo lloj specifik të kontratave në vijim:

Lloji i Kontratës	Përkufizimi
Kontratë për furnizim	Kontrata për furnizim lidhet ekskluzivisht ose kryesisht me <i>blerjen e një apo më shumë produkteve</i> ; por gjithashtu kontratat në lizing dhe marrje/dhënie me qira .
Kontratë për shërbime	Kontrata për shërbime lidhet ekskluzivisht ose kryesisht me <i>ofrimin e shërbimeve</i> . Shërbimet gjithashtu përfshijnë shërbimet konsulente .
Kontratë për punë	Kontrata për punë ka si qëllim kryesorë: <ul style="list-style-type: none"> - ekzekutimin, - projektimin dhe ekzekutimin, ose - realizimin me çfarëdo mënyre të <i>një pune, ndërtimi ose aktiviteti të inxhinierisë civile</i> që përfshinë: <ul style="list-style-type: none"> - ndërtime, - restaurime, - riparime ose - demolim të objekteve, hapësirave, struktura të inxhinierisë civile, ose ndonjë pjesë të tyre
Kontratë publike kornizë	Kontrata kornizë lidhet ekskluzivisht me krijimin e kornizës për porosi ose kontrata ndihmëse gjatë një periudhe të caktuar.

3.5 Megjithatë, është e mundshme për një kontratë publike të jetë “kombinim”: Furnizim/Shërbim, Punë/Shërbim; Punë/Furnizim; kombinim në Furnizim/Punë/Shërbime. Metoda bazike për të trajtuar këtë ndarje është gjithnjë *modeli i kostos së thjeshtë*. Cilido element i kontratës që ka shpenzimet më të larta të parashikuara, kontrata duhet të klasifikohet nën atë llojtë kontratës. Kjo duhet të aplikohet edhe nëse kontrata është ndarë në “Lote”; ajo do të jetë vlera totale e kontratës së plotë (të gjitha “lotet”).

3.6 Të gjitha AK-se gjatë përgaditjes dhe zhvillimit të një procedure të prokurimit duhet të aplikojnë rregullat në vijim në tabelën më poshtë që përcaktojnë llojin e kontratave të kombinuara:

Rregullat e Kontratave të Kombinuara	
Kombinimi	Kontrata e Krijuar
Një kontratë për furnizim që përfshinë: - <i>dorëzimin, dhe/ose</i> - <i>vendin, dhe/ose</i> - <i>instalimin</i>	<i>Kontratë për furnizim</i>
Një kontratë për <i>furnizim të produkteve dhe ofrim të shërbimeve</i>	<i>Kontratë për shërbime</i> , nëse vlera e parashikuar e shërbimeve tejkalon vlerën e parashikuar të produkteve. (përndryshe është kontratë për furnizim).
Një kontratë që ka si qëllim <i>kryesorë ofrimin e shërbimeve profesionale të lidhura me ndërtimtari</i> , dhe për më shumë ekzekutimin e një apo më shumë aktiviteteve të referuara në përkufizimin e “ <i>kontratës përpunë</i> ” Shërbime të lidhura me ndërtimtari mund të jenë: - shërbime arkitektuese dhe/ose shërbime inxhinierie, - shërbime të hulumtimeve gjeoteknike ose gjeodezike, - shërbime të vlerësimit të strukturës apo projektimit të strukturës, - shërbime të mbikëqyrjes së ndërtimtarisë ose shërbime të menaxhimit, etj.	<i>Kontratë për shërbime</i>
Një kontratë që ka si <i>qëllim kryesorë kryerjen e punëve</i> por përfshinë shërbime profesionale të lidhura me ndërtimtari (siç janë sqaruar mësipërm) të <i>domosdoshme</i> për ekzekutimin e kontratës	<i>Kontratë për punë</i>
Kontratë për <i>furnizim të produkteve dhe kryerje të punëve</i>	<i>Kontratë për punë</i> , nëse aktivitetet e punëve nuk janë vetë vendin dhe/ose instalim. (Përndryshe kontratë për furnizim).

3.7. **Informata obligative** të kërkuara gjatë kompletimit të Dosjes së Tenderit, në lidhje me LPP, janë si në vijim:

<u>Furnizimet</u>	<u>Shërbimet</u> konsulente dhe jo-konsulente	<u>Punët</u>
Një deklaratë e kërkesave për prokurimin e furnizimeve do të përmbajë përshkrime të plota, të sakta dhe precize të furnizimeve, orar të dorëzimit dhe përfundimit, listë të furnizimeve dhe sasive, specifikime teknike dhe projekttime, dhe do të përfshijë sipas nevojës:	Një deklaratë e kërkesave për prokurimin e shërbimeve do të përkufizohet në terme të referencës të cilat do të përmbajnë një përshkrim të qartë, të saktë dhe precizë të shërbimeve, dhe do të përfshijë sipas nevojës:	Një deklaratë e kërkesave për prokurimin e punëve do të përmbajë përshkrim të qartë, të saktë dhe precizë ose parametra të punëve, faturën e sasisë, specifikime teknike dhe projekttime, dhe do të përfshijë sipas nevojës:
(a) përkufizim të qartë të parametrave të blerjes së propozuar;	(a) një narrativ i prapavijës së shërbimeve të kërkuara;	(a) një narrativ i prapavijës së punëve të kërkuara;
(b) qëllimin dhe objektivat e blerjes së propozuar;	(b) objektivat e shërbimeve të kërkuara dhe një listë e qëllimeve për të arritur nga një ofrues i shërbimeve;	(b) objektivat e punëve të kërkuara;
(c) përshkrim të plotë të kërkesës;	(c) një listë e detyrave specifike ose kompetencave që do të ekzekutohen	(c) një listë e detyrave specifike për të ekzekutuar;
(d) specifikim të përgjithshme në nivel të mjaftueshëm të detajeve;	(d) një orar të dorëzimeve për rezultatete detyrave ndaj të cilave do të krahasohen arritjet e shërbimeve;	(d) kërkesat e mbikëqyrjes, raportet e punës dhe aranzhimet specifike administrative që do të aplikohen;
(e) përshkrim funksional të cilësive, përfshirë veçori të kërkuara mjedisore apo tësigurisë të lëndës së prokurimit;	(e) mënyrat e menaxhimit dhe raportimit të Operatorit të shërbimeve, të AK dhe aranzhimet specifike administrative dhe kërkesat e raportimit që do të aplikohen;	(e) kohëzgjatja e punëve;
(f) parametra të performancës, përfshirë rezultatet, afatet kohore, dhe çdo indikator tjetër ose kritere me të cilat performanca ekënaqshme e specifikimeve mund të vlerësohet;	(f) kohëzgjatja dhe orari i angazhimit;	(f) një standard i përbashkët i komunikimit
(g) përshkrimi i procesit dhe materialeve;	(g) standardet e aplikueshme të industrisë për implementimin e angazhimit; dhe	(g) standardi relevant i industrisë; dhe

(h) kërkesat të dimensionet, simbolet, terminologjia, gjuha, paketimi, shënimi dhe etiketimi	(h) çdo informatë tjetër shtesë.	(h) çdo informatë tjetër shtesë.
(i) një standard i përbashkët i specifikimeve		
(j) standardin relevant të industrisë; dhe		
(k) çdo informatë tjetër relevante.		
Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajn, lloj, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër. Kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për karakterizimin e kërkesave përveç referencës, përskrimi do të përdorët, pasuar nga fjalët “ose të barasvlershme”		
Dokumentet e tenderit për furnizime do të specifikojnë informatat në vijim:	Dokumentet e Tenderit për shërbime do të kërkojë nga Operatori ekonomik të komentoj për termat e referencës dhe do të specifikoj informatat në vijim:	Dokumentet e Tenderit për punë do të specifikojnë informatat në vijim:
(a) specifikimet dhe listën e furnizimeve duke përfshirë sasinë;	(a) termat e referencës dhe kontributi i prituri i personelit kyç	(a) hartimi, specifikat, projektimet dhe faturën e sasive
(b) përbërjen e Loteve; nëse lejohen variantet apo jo; nëse lejohen tërheqjet e Tenderëve para skadimit të afatit të dorëzimit;	(b) përbërja e Loteve; nëse lejohen variantet apo jo; nëse lejohen tërheqjet e Tenderëve para afatit të fundit për dorëzim apo jo;	(b) përbërja e Loteve; nëse lejohen variantet apo jo; nëse lejohen tërheqjet e Tenderëve para afatit të fundit për dorëzim apo jo;
(c) lloji i kontratës dhe procedurës	(c) lloji i procedurës së kontratës	(c) lloji i procedurës së kontratës
(d) kriteret e kualifikimit	(d) kriteret e kualifikimit	(d) kriteret e kualifikimit
(e) shuma dhe forma e kërkesës së sigurimit të tenderit;	(e) shuma dhe forma e sigurimit të tenderit që kërkohet;	(e) shuma dhe forma e sigurimit të tenderit që kërkohet;

(f) shuma dhe forma e kërkuar e sigurimit të ekzekutimit	(f) shuma dhe forma e sigurimit të ekzekutimit që kërkohet;	(f) shuma dhe forma e sigurimit të ekzekutimit që kërkohet
(g)afatet kohore, vendi ekzakt, data dhe kohae dorëzimit të tenderit dhe hapjes së tenderit	(g) afatet kohore, vendi ekzakt, data dhe koha e dorëzimit të tenderit dhe hapjes së tenderit	(g) afatet kohore, vendi ekzakt, data dhe koha e dorëzimit të tenderit dhe hapjes së tenderit
(h) forma e tenderit valid	(h) forma e tenderit valid	(h) forma e tenderit valid
(i) metodologjia e dorëzimit të tenderit	(i) metodologjia e dorëzimit të tenderit	(i) metodologjia e dorëzimit të tenderit
(j) valuta në të cilën duhet të dorëzohet tenderi	(j) valuta në të cilën duhet të dorëzohet tenderi	(j) valuta në të cilën duhet të dorëzohet tenderi
(k) periudha e validitetit të tenderit	(k) periudha e validitetit të tenderit	(k) periudha e validitetit të tenderit
(l) informata të përgjithshme për ankesa	(l) informata të përgjithshme për ankesa	(l) informata të përgjithshme për ankesa
(m) kushtet e pagesës, përfshirë ndonjë pagesë në avans, pagesa në faza, pagesa të mbajtura dhe sigurime të pagesës	(m) kushtet e pagesës, përfshirë ndonjë pagesë në avans, pagesa në faza, pagesatë mbajtura dhe sigurime të pagesës	(m) kushtet e pagesës, përfshirë ndonjë pagesë në avans, pagesa në faza, pagesatë mbajtura dhe sigurime të pagesës
(n) baza për çmime fikse ose variabile, dhe metodën e kalkulimit të variacioneve në çmimet variabile	(n) baza për çmime fikse ose variabile, dhe metodën e kalkulimit të variacioneve në çmimet variabile	(n) baza për çmime fikse ose variabile, dhe metodën e kalkulimit të variacioneve në çmimet variabile
(o) metoda e pagesës	(o) metoda e pagesës	(o) metoda e pagesës
(p) dokumentacioni që kërkohet për pagesë	(p) dokumentacioni që kërkohet për pagesë;	(p) dokumentacioni që kërkohet për pagesë
(q) kushtet e kërkuara të dorëzimit dhe periudha e dorëzimit	(q) kohëzgjatja, koha e kontributeve dhe orari i përfundimit	(q) orari i ekzekutimit të punëve
(r) kriteret e dhënies së kontratës përfshirë nën-kriteret dhe peshët e përcaktuara	(r) kriteret e dhënies së kontratës përfshirë nën-kriteret dhe peshët e përcaktuara	(r) kriteret e dhënies së kontratës përfshirë nën-kriteret dhe peshët e përcaktuara
(s) metodologjia e vlerësimit	(s) metodologjia e vlerësimit	(s) metodologjia e vlerësimit
(t)çdo kërkesë e veçantë për paketim, shënim dhe etiketim	(t) dorëzimet ose rezultate që kërkohen	(t)funksionet dhe autoriteti i menaxherit të projektit të AK
(u) çdo inspektim ose testim i kërkuar	(u) çdo kërkesë e sigurimit	(u) çdo inspektim ose teste që kërkohen, dhe metodat e testimit
(v) kërkesë në lidhje me certifikim të konformitetit	(v) çdo informatë tjetër ose kushte	(v) kërkesat në lidhje me certifikim të përshtatshmërisë
(ë) çdo kërkesë për sigurime		(ë) çdo kërkesë për sigurim

(x) çdo kërkesë për garancion		(x) çdo kërkesë për garancion
(y) çdo informatë tjetër apo kushte		(y) çdo informatë tjetër ose kushte
Një kontratë për furnizime do të tregojë qartë parametrat e përgjegjësive të një Operatori nën kontratë, që do të përfshijë	Një kontratë për shërbime do të përfshijë	Një kontratë për punë do të theksojë qartë parametrat e punës dhe përgjegjësinë për projektim
<p>(a) furnizim dhe dorëzim i furnizimeve, në pajtim me INCOTERM;</p> <p>(b) instalimet dhe komisionimi i furnizimeve;</p> <p>(c) trajnimet për përdorim, mirëmbajtje ose riparim të furnizimeve; ose</p> <p>(d) dispozitat e shërbimeve pas shitjes, që mund të përfshijnë furnizimin dhe dorëzimin e materialeve shpenzuese dhe pjesëve rezervë dhe servisimit, mirëmbajtjes, riparimit, kalibrimit dhe modifikimit të pajisjeve.</p>	<p>(a) pronësia e tërë pronës së blerë ose të përdorur gjatë implementimit të kontratës;</p> <p>(b) obligimet e një Operatori në lidhje me kujdesin dhe mbikëqyrjen e pronës së AK-së, që është në shfrytëzim gjatë implementimit të kontratës;</p> <p>(c) aranzhimet për dorëzimin e kthimin e tërë pronës së AK-së në shfrytëzim gjatë implementimit të kontratës; dhe</p> <p>(d) aranzhimet për dorëzim, nëse aplikohet, e tërë pronësisë të blerë gjatë implementimit të kontratës</p>	<p>(a) procedura për transfer të punëve të përfunduara të AK, përfshirë transferin e titujve dhe dokumentacionit të transferimit;</p> <p>(b) pronësia e pronës në vendin e punimeve gjatë implementimit të kontratës;</p> <p>(c) obligimet e një Operatori në lidhje me kujdesin dhe mirëmbajtjen e pronës së AK-së, në shfrytëzim gjatë implementimit të kontratës; dhe</p> <p>(d) aranzhimet për dorëzim të përkohshëm dhe përfundimtarë të gjithë pronës së AK, të shfrytëzuar gjatë implementimit të kontratës.</p>

Shënim: Informatat obligative të kërkuara gjatë kompletimit të Dosjes së Tenderit dhe të specifikuar në tabelën më lartë janë të përfshira edhe në RRPP, por të cilat janë përsëritur edhe në këtë udhëzues në mënyrë që AK-se të udhëzohen t'i kenë parasyshë gjatë përgaditjes së Dosjes së Tenderit, gjithmonë duke shmangur përgaditjen e DT në një mënyrë që favorizon ose diskriminon një ose më shumë Operatorë Ekonomik potencial.

4. Ndarja e kontratave në Lote

4.1 Autoriteti Kontaktues mund të ndaj aktivitetin e prokurimit në Lote homogjene apo heterogjene. Në të gjitha rastet OE janë të lirë të zgjedhin për sa dhe cilat pjesë do të ofertojnë.

4.2 Kurdo që AK ndan aktivitetin në Lote, AK duhet të përcaktoj, në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit, **kriteret minimale të përzgjedhjes, të veçanta për secilën pjesë (lot). Kriteret e tilla duhet të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale në raport me objektin, lëndën dhe vlerën e lotit, si dhe të përcaktojnë** nëse OE do të shpërblehen për:

- a) të **gjitha Lotet**; apo
- b) një **numër të caktuar të Loteve**.

Shënim: Në mënyrë që të nxitet përfshirja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në tregun kombëtar të prokurimit publik, kufizimi i numrit të Loteve preferohet kur ka shumë OE dhe shumë NVM.

Shembujt e mëposhtëm të kriterëve objektive dhe jo-diskriminuese nuk janë të vetmet kritere dhe nuk janë obligative. Kriteret duhet të përzgjidhen sipas nevojës së Autoritetit Kontraktues dhe lëndës së kontratës.

Shembulli 1:

Objekti i kontratës është i ndarë në **3 Lote**.

Tenderuesi mund të paraqesë tender për të gjitha Lotet.

Numri maksimal i Loteve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: **2 (dy)**.

Në rast se Tenderuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se 2 Lote atëherë ai do të shpërblehet me kontratë për lotet që ofrojnë çmimin më të ulët të mundshëm për autoritetin kontraktues dhe Loti tjetër do t'i shpërblehet Operatorit të dytë me radhë.

<u>Lot</u>	<u>OE 1</u>	<u>OE 2</u>
<u>1</u>	<u>190,000.00</u>	<u>200,000.00</u>
<u>2</u>	<u>225,000.00</u>	<u>250,000.00</u>
<u>3</u>	<u>175,000.00</u>	<u>200,000.00</u>

OE1 do të shpërblehet për Lot 2 dhe 3 (400,000.00) ndërsa OE2 për Lot 1 (200,000.00) sepse ky është kombinimi me i mirë i mundshëm.

Ilustrim i shembullit:

Kombinimi 1			
	<u>OE 1</u>	<u>OE 2</u>	<u>AK paguan</u>
2	225,000	200,000	
3	175,000		
	400,000	200,000	600,000
Kombinimi 2			
	<u>OE 1</u>	<u>OE 2</u>	<u>AK paguan</u>
1	190,000	250,000	
3	175,000		
	365,000	250,000	615,000
Kombinimi 3			
	<u>OE 1</u>	<u>OE 2</u>	<u>AK paguan</u>
1	190,000	200,000	
2	225,000		
	415,000	200,000	615,000

4.3 Kurdo që AK përcakton kriteret minimale për gjendjen ekonomike dhe financiare apo aftësinë teknike dhe profesionale, në rastet kur kufizon numrin e Loteve që do të shpërblehen tek një OE, AK duhet të merr parasysh që përmbushja e kërkesave minimale të jetë shuma më e lartë për Lotet për të cilat konkurron OE.

Shembull 2: Kërkesat e gjendjes ekonomike dhe teknike profesionale

Ndarja në Lote: 3 Lote

Tenderuesi mund të paraqesë tender **për një apo me shume pjesë (lote).**

Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: **1 (një).**

Në rast se OE tenderues paraqet tender në një apo më shumë LOTE dhe ofron çmimin më të ulët në më shumë se 1 Lot, AK do të shpërblej OE për LOT-in më të favorshëm për AK.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2020-2021-2022) ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se:

1. Për lot 1, **300,000.00 Euro**
2. Për lot 2, **200,000.00 Euro**
3. Për lot 3, **100,000.00 Euro**

Dokumentet dëshmuese për gjendjen ekonomike dhe financiare

Evidenca 1: Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose vendit të themelimit për tri vitet e fundit (*tri vitet duhet të jenë vite të plota fiskale*).

Në rast se Operatori ekonomik dorëzon tender për 2 Lote, shuma më e lartë e qarkullimit financiar që kërkohet për Lotet për të cilat konkurrenca duhet të përmbushet nga OE.

Shënim:

- nëse OE vendos që të konkurrojë në Lot 1 dhe 2, atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet të përmbushet nga OE është 300,000.00 euro.
- nëse OE vendos që të konkurroj në Lot 2 dhe 3, atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet të përmbushet nga OE është 200,000.00 euro.
- nëse OE vendos që të konkurroj në Lot 1, 2 dhe 3, atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet të përmbushet nga OE është 300,000.00 euro.

I njëjti kriter vlenë edhe për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale.

4.4 Nisur nga fakti, se qëllimi i kufizimit të numrit të Loteve është që të rritet konkurrenca dhe, *në mënyrë që të lejohet qasje maksimale për fondet publike*, të ndahet tregu në mesin e numrit të madh të Operatorëve ekonomik, kjo dispozitë është e aplikueshme vetëm kur ka tender të mjaftueshëm të përgjegjshëm për të aplikuar këtë rregull. Kur nuk ka tender të përgjegjshëm të mjaftueshëm për të shpërblyer të gjitha Lotet mbizotëron interesi i AK që të shpërblej të gjitha Lotet. Pra, në mungesë të konkurrentëve të tjerë, OE shpërblehen për më shumë Lote se sa numri maksimal i përcaktuar nga AK.

Shembull:

Ndarja në Lote: **7 Lot-e**

Kufizimi i numrit të Loteve: **maksimum 2 Lote.**

Pranohen **5 oferta por vetëm 2 janë të përgjegjshme**, atëherë **2 OE shpërblehen me nga 2 Lote (gjithsej 4 lote)** sipas formulës së përcaktuar në Dosje të tenderit, ndërsa **3 Lotet tjera** shpërblehen tek OE i cili ka dorëzuar tenderin e renditur i pari (ofertën më të ulët), edhe pse ai tashmë ka 2 Lote të shpërblyera.

5. Specifikimet Teknike

- 5.1 Në zbatim të Nenit 28 dhe 29 të LPP, AK do të parashtrorj në dosjen e tenderit të gjitha specifikimet teknike të cilat çdo tender duhet ti përmbush.
- 5.2 Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës në prokurimin publik.
- 5.3 Një specifikim teknik do të theksohet, për aq sa është e mundur, duke ju referuar **standardeve** të mirënjohura por mund të formulohet gjithashtu në aspektin e performancës apo kërkesave funksionale. Një AK mund të përdorë standardet për karakteristika të caktuara dhe performancë ose kërkesa të funksionalitetit për karakteristika tjera.

Referencë në një standard të njohur:

Hierarkia e Standardeve që do të referohet gjatë formulimit të specifikimeve teknike

- (1) një standard i Kosovës që implementon një standard të Evropës,
- (2) një standard Evropian,
- (3) një aprovim teknike Evropian,
- (4) një specifikim i përbashkët teknik,
- (5) një standard ndërkombëtarë dhe/ose
- (6) çdo sistem tjetër i referencës teknike i prodhuar nga organet Evropiane të standardizimit.

Re(1): Agjencia Kosovare për Standardizim implementon standardet Evropiane në Kosovë.

Re(2): Standardet Evropiane aprovohen nga Komisioni Evropian për Standardizim (CEN), www.cenorm.be, dhe Komisioni Evropian për Standardizimin Elektro-teknik (CENELEC), www.cenelec.org.

Re(3): Arovimet Evropiane teknike (sektori i ndërtimtarisë) nxjerrën nga organe të aprovimit në Shtetet Anëtare të BE-së në bazë të “kërkesave esenciale” të përbashkëta.

Re(4): Specifikim i përbashkët teknik do të thotë një specifikim teknik i përcaktuar sipas një procedure të BE-së.

Re(5): Standarde ndërkombëtare janë për shembull ISO, www.iso.org, ASTM, www.astm.org etj.

Re (6): ndonjë referencë tjetër të prodhuar nga institucionet Evropiane.

5.4 Nëse nuk ekziston një standard i aplikueshëm ose standarde të tilla nuk do të ishin efikase në aplikim për arsye teknike apo ekonomike – AK mund të referohet te:

- një standard i Kosovës, ose
- një aprovim teknik të Kosovës

5.5 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, si rregull i përgjithshëm është i **ndaluar**. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “**ose e barasvlershme/ekuivalente**”.

5.6 Specifikimet teknike janë kërkesa të obligueshme, të cilat të gjithë tenderët duhet të respektojnë në mënyrë që të jenë të përgjegjshëm.

5.7 Në disa raste, AK mund të specifikojë funksione të dëshirueshme, performancë etj. dhe të përfshijë specifikime të tilla në kritere, mbi të cilat tenderuesit vlerësohen (parametrat e konkurrencës). Kjo do të thotë që funksionet e tilla të dëshiruara mund të përcaktohen si nën-kritere (“karakteristikat funksionale”) për tenderin ekonomikisht më të favorshëm.

5.8 Një dallim i qartë në mes të kërkesave të obligueshme dhe funksioneve të dëshiruara duhet të bëhet nga AK.

6. Afatet kohore

6.1 Për të caktuar afatet kohore, AK duhet të merr parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohës së kërkuar për përgatitjen e tenderëve. Me fjalë tjera, AK-të nuk lejohen të përcaktojnë afate kohore të cilat janë më të shkurta se ato të caktuara me Ligj (afatet kohore minimale) por janë të lirë të përcaktojnë afate kohore më të gjata në mënyrë që të mundësojnë OE kohën e duhur për përgatitjen e ofertave.

6.2 Afatet kohore do të kalkuloohen në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose në datën kur të gjitha ftesat për dorëzim të tenderit dërgohen.

Afatet kohore normale

	Procedurat		
	E hapur	E kufizuar	Konkurrese me negociata
Me vlerë të madhe	40 ditë	20 ditë pranimi i kërkesave 40 ditë pranimi i tenderëve	10 ditë pranimi i kërkesave 20 ditë pranimi i tenderëve
Me vlerë të mesme	20 ditë	15 ditë pranimi i kërkesave 20 ditë pranimi i tenderëve	10 ditë pranimi i kërkesave 20 ditë pranimi i tenderëve
Me vlerë të vogël	5 ditë	/	/
Me vlerë minimale	1 ditë	/	/

Nëse Njoftim Paraprak*

	Procedurat	
	E hapur	E kufizuar
Me vlerë të madhe	24 ditë	20 ditë pranimi i kërkesave 24 ditë pranimi i tenderëve

* vetëm nëse data e publikimit të njoftimit indikativ ka ndodhur jo më pak se **40 ditë** dhe jo më shumë se **12 muaj** paraprakisht datës së publikimi.

Afate kohore të përshpejtuara

	Procedurat	
	E hapur	E kufizuar
Me vlerë të madhe	15 ditë	15 ditë pranimi i kërkesave 10 ditë pranimi i tenderëve

<i>Me vlerë të mesme</i>	10 ditë	15 ditë pranimit i kërkesave 10 ditë pranimit i tenderëve
--------------------------	----------------	--

7. Ofrimi i informacioneve shitesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore

7.1 Një OE, mund të kërkojë, *me shkrim*, informata shitesë sqaruese për dokumentet e tenderit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik – vetëm nëpërmjet funksionit të dedikuar për kërkesa për sqarime.

7.2 AK do të përcaktoj afatet kohore në DT për pranimin e kërkesave të tilla si në vijim:

<i>Nëse afati kohorë për pranimin e tenderëve është</i>	<i>Jo më pak se</i>
≥ 40 ditë	20 ditë Para pranimit të tenderëve
≥ 30 ditë por < 40 ditë	15 ditë Para pranimit të tenderëve
≥ 20 ditë por < 30 ditë	10 ditë Para pranimit të tenderëve
≥ 5 ditë por < 20 ditë	3 ditë Para pranimit të tenderëve

8. Kriteret e përzgjedhjes

8.1 Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse:

1. Një OE ***vërteton të jetë i*** përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues *dhe*
2. Një OE *i tillë, në rast që AK ka përcaktuar* ***kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla*** dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së.

Grupi i parë, kërkesat e pranueshmërisë, gjithnjë duhet të përmbushen nga OE.

Grupi i dytë, kërkesat minimale të kualifikimi, mund të përcaktohen nga AK kur AK konstaton se është e nevojshme për të siguruar që vetëm OE që posedojnë aftësi të caktuara profesionale, financiare ose teknike do të marrin pjesë në konkurrencë për kontratë.

8.2 “Kriteret e përshtatshmërisë” dhe “kërkesat minimale të kualifikimit” së bashku karakterizohen si “Kritere të Përzgjedhjes”. Kriteret e Përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike.

8.3 Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar.

Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

8.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. “Të arsyeshme dhe të mjaftueshme” do të nënkuptoj në lidhje me:

- i. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe
- ii. përdorim të drejtë të fondeve publike.

8.5 Kriteret e përzgjedhjes:

- i. në asnjë mënyrë nuk mund të përdorën si kritere të dhënies së kontratës
- ii. nuk mund të kenë peshë të caktuara;
- iii. ato janë *kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon*

Njëra ose tjetra

Kërkesat janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë janë ende në konsideratë,

ose

Kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë do të refuzohen menjëherë

- Tabela e mëposhtme paraqet **Kriteret e përzgjedhjes** që mund të përdorën nga Autoriteti Kontraktues:

Kriteret e Përzgjedhjes			
	Çështja	Kërkesa	Dëshmia Dokumentuese
Kërkesat e Përshtatshmërisë	Evitimi i “konfliktit të interest”	a) Asnjë personel i OE nuk mund të merr pjesë në përgatitjen e dosjes së tenderit	a. Deklarata nën betim e nënshkruar
		b) Asnjë personel i OE nuk mund të pranoj asistencë në përgatitjen e tenderit të tij nga personeli i AK që ka përgatitur dosjen e tenderit	b. Deklarata nën betim e nënshkruar
		c) Asnjë personel i OE nuk mund të ketë një konflikt interesi, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1.75 i LPP-se	c. Deklarata nën betim e nënshkruar
	Historiku i OE dhe menaxhmentit të tij për 10 vitet e fundit	a) Nuk është shpallur i fajshëm nga një gjykatë për praktika të korrupsionit	a. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit

		b) Nuk është deklaruar i papërshtatshëm nga një gjykatë kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rënde profesionale	b.Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit
		c) Nuk është shpallur i fajshëm nga një gjykatë për pjesëmarrje në aktivitete të një organizate kriminele	c.Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit
		d) Nuk është shpallur i fajshëm nga një gjykatë për kryerjen e një akti të mashtrimit ose një akti të ngjashëm	d.Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit
		e) Nuk është shpallur nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale	e.Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit
		f) Nuk është shpallur nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime serioze	f. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit

	Historiku ekonomik – Sigurimi i besueshmërisë së OE	a) gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent	a. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit
		b) me vendim të një gjykate kompetente nuk është likuiduar ose nuk është vënë në mbikëqyrje	b. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit
		c) Nuk ka aranzhim me kreditorët në bazë të insolvencës paraprake	c. Deklarata nën betim e nënshkruar
		d) Nuk është në gjendje të krahasueshme me a, b ose c.	d. Një vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësorë ose administrativ i vendit të themelimit të tenderuesit
		e) Nuk ka humbur aktualisht të drejtën për të shitur pronën e tij	e. Deklarata nën betim e nënshkruar
		f) Nuk është në procedura që mund të rezultojnë në falimentim	f. Deklarata nën betim e nënshkruar
		g) nuk është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë gjatë tri (3) viteve të fundit	g. Deklarata nën betim e nënshkruar
		h) nuk është me vonesë në pagimin e tatimeve ose kontributeve të sigurimit sociale	h. Në lidhje me tatimet një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore të vendit të themelimit që OE nuk është me vonesë në pagesën e tatimeve të paktën deri në çerekun e fundit të vitit; dhe në lidhje me sigurimin social, një certifikatë të lëshuar nga autoritetet

			kompetente ose Operatorë publik që vërteton se një gjendje e tillë nuk ekziston
		i) Nuk është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një Operatori të shërbimeve publike	i. Një certifikatë lëshuar nga autoritetet kompetente ose Operator publik që vërteton që një gjendje e tillë nuk ekziston
		j) ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës	j. Deklarata nën betim e nënshkruar
		k) ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënie të një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes	k. Deklarata nën betim e nënshkruar
		l) nuk është i diskualifikuar nga OSHP	l. Deklarata nën betim e nënshkruar
Kërkesat minimale të kualifikimit	1. Përshtatshmëria profesionale	a) Regjistrimi i Biznesit në vendin themelimit të OE që dëshmon regjistrimin e OE në regjistrin e profesional, komercial dhe/ose korporativ.	a. Dëshmi ose një kopje e certifikatës së biznesit
		b) Autorizim ose licencim ose anëtarësim në një	b. Nje kopje e autorizimit/licencës/dëshmisë të anëtarësisë ose deklaratë nën betim që

		organizatë të veçantë për shërbime profesionale të lëshuar nga një autoritet publik	një kërkesë e tillë nuk ekziston në shtetin e tyre	
2. Gjendja ekonomike dhe financiare	a) Kërkesat minimale të gjendjes ekonomike/financiare		a. Deklaratë adekuate ose deklarata nga një ose më shumë banka; ose	
			b. Dëshmi të policës relevante të sigurimit të lëshuar nga një kompani e licencuar dhe me reputacion; ose	
			c. Kopje të certifikuara të një ose më shumë pasqyrave të bilancit ose pjesë të pasqyrës së bilancit; ose	
			d. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose	
			e. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.	
3. Aftësitë teknike dhe/ose profesionale	Në rast të kontratës për furnizim të produkteve:			
			a) Vlera minimale në lidhje me furnizimet në 3 vitet e fundit	a. Një listë që liston furnizimet kryesore relevante të OE që specifikon: produktet e përfshira, shumën kontraktuale, datën dhe pranuesin / certifikata e pranimit
			b) Kërkesat minimale të mundësive teknike të OE	b. Përshkrim i mundësive teknike të OE

	c) Kërkesat minimale për masat e sigurimit të cilësisë	c. Përshkrim i organizimit të sigurimit të cilësisë dhe masave
	d) Mundësitë e kërkuara për hulumtime dhe zhvillim	d. Përshkrim i mundësive për hulumtime dhe zhvillim
	e) Numri minimal i teknikëve ose organeve teknike të përfshira, në veçanti për kontrollim të cilësisë	e. Përshkrim i teknikëve ose organeve teknike të përfshira dhe CV-të e tyre
	f) Mostra, përshkrime, fotografi, etj.	f. Mostrat e produktit, prezantime grafike dhe/ose fotografi të produkteve për furnizim
	g) Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet.	g. Kopje të Certifikatës
	h) Inspektimi, në rast të produkteve komplekse ose të përdorimit të veçantë	
	Në rast të kontratës për ofrimin e shërbimeve:	
	a) Kualifikimet minimale profesionale dhe edukative të stafit menaxheriale	a. Lista e kualifikimeve profesionale dhe edukative dhe CV-në e tyre
	b) Vlera minimale në lidhje me shërbimet në 3 vitet e fundit	b. Një listë që specifikon parimet relevante të performancës që specifikon: shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin / certifikata e pranimit

		c) Numri dhe kualifikimet minimale të teknikëve ose organeve teknike të përfshira në veçanti ato të kontrollit të cilësisë	c. Shënime për teknikët dhe organet teknike të përfshira dhe CV-të e tyre
		d) Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore për secilin nga 3 vitet	d. Deklaratë të mesatares së fuqisë punëtore të OE dhe numrin mesatarë të stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet
		e) Kërkesa minimale për Veglat, hapësirat ose pajisjet teknike	e. Një deklaratë të veglave, hapësirave ose pajisjeve teknike në dispozicion të tenderuesi që ofron shërbimet
		f) Kërkesat minimale për masat e sigurimit të cilësisë	f. Përshkrimi i organizatës dhe masave të sigurimit të cilësisë
		g) Hapësirat e nevojshme për hulumtime dhe zhvillim	g. Përshkrim i hapësirave të hulumtimit dhe zhvillimit
		h) Elementet e parashikuara për nën-kontraktim	h. një shënim të elementeve të kontratës në fjalë që tenderuesi parasheh të nën-kontraktit
		i) Informata tjera të duhura dhe relevante	
		j) Inspektimi, në rast të shërbimeve komplekse ose të qëllimeve të veçanta	
		Në rast të kontratës për ekzekutimin e projekteve punuese ose performancës së aktiviteteve të ndërtimitarisë:	

		a) Kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxherial	a. Kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxherial dhe CV-të e tyre
		b) Vlera minimale në lidhje me shërbimet në 3 vitet e fundit	b. Një listë që specifikon secilin nga projektet punuese të OE dhe aktiviteteve të ndërtimit të kryera nga OE në 3 vitet e fundit të përcjellur me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën dhe llojin dhe vendin e projektit punues dhe/ose aktiviteteve të ndërtimit/ certifikata e pranimit
		c) Kërkesa minimale për Veglat, hapësirat ose pajisjet teknike	c. Një deklaratë të veglave, hapësirave ose pajisjeve teknike në dispozicion të tenderuesi që ekzekuton projektin për punë
		d) Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet	d. Deklaratë të mesatares së fuqisë punëtore të OE dhe numrin mesatarë të stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet
		e) Numri minimal i teknikëve të punësuar	e. Shënime për teknikët dhe organet teknike të përfshira
		f) Informata tjera relevante dhe të nevojshme	

i. Shënim për kërkesat e pranueshmërisë (neni 65 i LPP-së):

Qëllimi i këtij kriteri është që të vlerësojë nëse tenderuesi i plotëson kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 65 të LPP-së si në vijim:

- a. në lidhje me Nenin 65, paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të LPP-së, deklaratë nën betim e nënshkruar nga Operatori ekonomik në fjalë;
- b. në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit e themelimit të Operatorit ekonomik;
- c. në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8, për sigurimet sociale, dhe 4.9 të LPP-së, një çertifikatë e lëshuar nga autoriteti kompetent ose Operatori publik që dëshmon se një situatë e tillë nuk ekziston.
- d. në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 të LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik.

Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. **Në rastet specifike, AK me kërkesë të OE të arsyetuar bindshëm, mund të zgjasë afatin e caktuar.**

Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.

ii. Shënim për kërkesat e përshtatshmërisë profesionale (neni 66 i LPP-së):

Në rast kur, operatorët ekonomik janë të obliguar nga autoriteti kontraktues për të paraqitur dëshmi dokumentuese të përshtatshmërisë profesionale të përmendura në nenin 66.2 të LPP, operatori ekonomik duhet të dorëzojë autorizimin, licencën për vërtetimin e përshtatshmërisë profesionale. Në rast grupi operatorësh ekonomik, kjo kërkesë vlenë ndaj grupit si tërësi, mirëpo i pajisur me autorizim apo licencë në kuptim të këtij neni duhet të jetë anëtar i grupit i cili kryen furnizimin, shërbimin apo punën.

iii. Shënim për kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare (neni 68 i LPP-se):

Qëllimi i këtij kriteri është që të vlerësojë nëse tenderuesi ka stabilitetin e mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të përformuar kontratën e propozuar. Në përgjithësi, Operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:

- a. Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;
- b. Evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;
- c. Kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të Operatorit ekonomik
- d. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose
- e. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose nga vendi i themelimit.

a. Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka

Në rast të kontratave me vlerë të madhe, kur Operatori ekonomik ka për të financuar zbatimin e kontratës, është e dobishme për të kërkuar shumë të caktuar të likuiditetit ose për të njëjtën vlerë shënim premtues për kredi. Mund të sigurojë se Operatori ekonomik do të merr kredi nga banka në rast nevojë, ose kompania ka të holla (cash) dhe është në gjendje të zbatojë kontratën pa kredi. Për më tepër, banka mund të vërtetojë se Operatori ekonomik paguan rregullisht pa vonesë shpengimin e tij të kreditit, e cila gjithashtu është një garanci se Operatori ekonomik ka sfond solid financiar.

Shembull:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 500.000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 500.000 euro qasje për kredi në dispozicion.

Dëshmia dokumentare 1. Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e 500.000 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej 500.000 EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

b. Evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve

Kompania e sigurimit mund të lëshojë vetëm policen e sigurimit që vërteton se Operatori ekonomik ka një sigurim të vlefshëm për një qëllim të caktuar (p.sh. produkte, përgjegjësi), shumën e sigurimit dhe periudhën e vlefshmërisë.

Kompania e Sigurimeve nuk ka rol tjetër dhe nuk mund dëshmoj asgjë për llogaritë bankare, të ardhurat, bilancet.

Fushat ku ka kuptim që të kërkohet sigurimi i shërbimeve me polica të sigurimit: punët ndërtimore, shërbimet e projektimit dhe mbikëqyrjes, shërbimet e udhëtimit. Gjithashtu është e rëndësishme që të përcaktohet numri i dëmeve dhe vlera e dëmit që do të mbulohet nga polica e sigurimit.

c. Kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të Operatorit ekonomik”

Një bilanc është një pasqyrë e pozitës financiare të kompanisë në një pikë të vetme në kohë, në shumicën e rasteve, në fund të vitit të biznesit. Një bilanc përmbledh pasurinë e kompanisë, detyrimet dhe kapitalin aksionar në një kohë të caktuar. Këto tri segmente të bilancit japin një ide se çfarë zotëron dhe ka borxh kompania, si dhe shuma e investuar nga aksionarët.

d. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur

Llogaritë e audituara mund të kërkohen vetëm për 3 vitet e fundit. Nëse kompania është themeluar para 1 ose 2 viteve për shembull kompania nuk mund të refuzohet për shkak se ka llogarite e audituara për vetëm një ose dy vite.

Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese **nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës.** Kërkesa për qarkullim duhet të shprehet detyrimisht në shifra dhe duhet t'i referohet maksimum tri viteve të fundit financiare. Vitet e tilla financiare duhet të përcaktohen qartë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje. *Kur, përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kjo nënkupton se Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesën për qarkullim specifik nëse ka përfunduar një apo disa kontrata të një natyre të ngjashme që vetëm ose sëbashku arrijnë totalin e vlerës së specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe nuk kërkohet që kjo kërkesë në vlerën e përcaktuar prej 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës të plotësohet vetëm me një kontratë të vetme të asaj vlere.*

e. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës

Shembull:

Kërkesa: OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjate 3 viteve të fundit ka qene ne vlere, se bashku ne të tri vitet e fundit financiare prej jo më pak se: 500,000 Euro.

Dëshmi: Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit financiare.

Shënim: Kërkesa e gjendjes ekonomike dhe financiare është një kusht minimal për kualifikim. Do të thotë se të gjithë tenderët që përmbushin këtë kërkesë minimale përmbushin kushtin e gjendjes ekonomike, dhe nuk kane rëndësi rastet kur dëshmia është shume me e madhe se kërkesa minimale e përcaktuar.

Në rastin kur kërkesa e gjendjes ekonomike dhe financiare i referohet një qarkullimi total prej 3,000,000 euro në tri vitet e fundit dhe Operatori ekonomik përmbush kërkesën e përcaktuar ne dokumentet e tenderit në vetëm dy vite apo një vit, konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale. Kushti minimal është përmbushur duke prezantuar dëshmitë e qarkullimit total prej 3,000,000 € në tri vite, dhe nuk ka rëndësi se sa ka qenë qarkullimi në secilin vit veç e veç.

iv. Shënim për kërkesat e aftesise teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-së):

- Në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, AK mund të kërkoj nga OE një listë të projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit. Kësaj liste duhet t'i bashkëngjiten si dëshmi:
 1. Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.
 2. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
- Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “ **të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “ në periudhën e shkuar trevjeçare...”**). Ne kuptimin e Ligjit shprehja **“tri vitet e shkuara”** nënkupton: “periudhën kohore të përcaktuar ne këto nene e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontrate ose, ne rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.
- Ne kuptim të nenit 69 paragrafi 2.1, 4.2 dhe 6.2 shprehja “.....te realizuara ne tre vitet e shkuar” nënkupton **Kontratat për furnizime, shërbime dhe/ose punë të realizuara** (përfunduara) në periudhën e shkuar tre vjeçare (periudha e sqaruar si më lartë).
- Ne këto situata rekomandohet qe data nga e cila fillon të kalkulohet periudha e shkuar tre vjeçare të vendoset data e publikimit të Njoftimit për kontratë, përkatësisht e dërgimit të ftesës për pjesëmarrje.

Këshillë: Shumë AK i aplikojnë kërkesat e nenit 68 dhe/ose 69 të LPP-së edhe për rastet kur nuk kanë ndonjë rëndësi apo nevojë për tu dëshmuar (p.sh. për aktivitetet të cilat kanë për qëllim furnizimin me mallra e të cilat nuk prodhohen nga ofruesi i tyre). Në këto aktivitete aplikimi i kritereve nga neni 68 dhe/ose 69 të LPP nuk është i arsyeshëm përkundrazi është jo profesional dhe mund të shkaktoj probleme të panevojshme.

v. Shënim për evidencën dokumentuese:

- Periudha kohore e historikut për evidencën dokumentuese nën **kërkesat e përshtatshmërisë** kalkulohet nga data e publikimit të Njoftimit të Kontratës ose në rast të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, data kur ftesa për pjesëmarrje është dërguar.
- Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo me pakse pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. **Në raste specifike, AK me kërkesë të OE të arsyetuar bindshëm, mund të zgjasë afatin e caktuar.** *Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.*
- Në raste kur lëshimi i dokumenteve ose certifikatave, nën **kërkesat e përshtatshmërisë profesionale** nuk janë të arritshme për arsye objektive, ose kur këto dokumente nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat evidenca duhet të prodhohet, një deklaratë e shkruar në betim nga OE mund të pranohet si evidencë e mjaftueshme. (neni 66 i LPP-së).
- Në rast të procedurës së kufizuar ose konkurruese me negociata, vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë do të kërkohen që të dorëzohen nga kandidatet të cilët autoriteti kontraktues ka për qëllim që ti ftoj për tenderim (listë të ngushte). Këto dokumente duhet të dorëzohen nga Kandidatet para vendimit final të para-kualifikimit nga Autoriteti Kontraktues. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo me pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e para-kualifikimit të kandidatit. **Në raste specifike, AK me kërkesë të OE të arsyetuar bindshëm, mund të zgjasë afatin e caktuar.** *Dështimi në dorëzimin e dokumenteve të tilla, do të thotë kandidati do të refuzohet dhe autoriteti kontraktues do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-*

listë. I njëjti kusht vlen edhe për OE gjatë konkludimit të një marrëveshje kornizë me disa OE – mini konkurrencë.

- Operatorit Ekonomik mund të lejohet të tregoj **gjendjen e tij ekonomike/financiare** përmes çfarëdo dokumenti tjetër nga ato që AK kërkon nëse OE ofron arsye valide dhe AK i konsideron ato adekuate (Neni 68.3 i LPP-së). Sipas kërkesës se një Operatori ekonomik për t'iu lejuar për të përdorur dokumentacionin alternativ siç është përmendur në këtë pjesë, autoriteti kontraktues duhet ti jap kohën e mjaftueshme Operatorit ekonomik për dokumentacionin e përmendur. Afati kohorë i tillë nuk mund të jetë më pak se pesë (5) ditë.
- Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së. AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare nga lideri i grupit të OE.

Shembull:

Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktoj ne Njoftimin për kontratë se lideri i grupit preferohet të përmbush se paku 51% e këtij qarkullimi minimal.

Në rast të furnizimeve, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Një informatë se si grupi duhet t'i plotësojë kërkesat nga ky paragraf, duhet të vendoset në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Autoriteti Kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në ftesën për tenderim do të specifikojë se cilat referenca (dokumente) të saktësuara në këtë nen i nevojiten.

9. Kriteret e dhënies së kontratës

9.1 Autoritetet kontraktuese mund të zgjedhin të bëjnë dhënien e kontratës në bazë të:

- Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët ose*
- Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm*

9.2 Kur çmimi është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ultë që përmbushë kërkesat e specifikuara.

9.3 Nëse kriteri për dhënie të kontratës është “Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF)”, kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante. Përveç çmimit, AK mund të përfshijë kritere tjera relevante për lëndën e kontratës. Për shembull, mund të përfshihet:

- Karakteristikat e cilësisë;
- Kostot operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë
- Karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme;
- Shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike;

9.4 Kriteret duhet të përcaktohen me peshë sipas rëndësisë relative, me përqindje ku të gjitha nën-kriteret përbërëse arrijnë në 100 %.

9.5 Autoriteti kontraktues mund të specifikojë peshën relative që i jep secilit prej kriterëve të zgjedhura për të përcaktuar tenderin ekonomikisht të favorshëm.

Shembull: Çmimi 50%, Cilësia 30%, Koha e dorëzimit 20%.

9.6 Sipas praktikës më të mirë, ekuilibri më i mirë në poentim për të garantuar vlerën më të mirë për paranë, përveç disa situatave specifike që lidhen me veçantinë e tregut (për shembull, blerja e zgjidhjeve inovative ose zhvillimi i furnizimeve të teknologjisë së lartë), zakonisht përcaktohet duke cituar dy komponentët 60 pikë (oferta teknike) kundrejt 40 pikë (oferta ekonomike), ose 70 me 30.

9.7 Identifikimi i kriterëve (dhe çdo nën-kriteri) që do të aplikohet duhet të kryhet me kujdesin e duhur në fazën e përgatitjes së Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontratë dhe përcaktimi i tyre duhet të synojë arritjen e vlerës më të mirë për para.

9.8 Mos përfshirja e kriterëve përkatëse ose përfshirja e kriterëve të papërshtatshme me gabim mund të nënkuptojë që oferta që ofron vlerën më të mirë për para nuk është zgjedhur. Kriteret në përgjithësi do të vlerësohen duke përdorur një sistem vlerësimi ose një rregull të pikëve, i cili cakton koeficientët me kriteret e përdorura.

9.9 Gjithashtu, kriteret dhe nën kriteret duhet të formulohen në mënyrë të qartë në mënyrë që të jenë plotësisht të kuptueshme për tenderuesin. Për shembull, është e rekomandueshme që të formulohen kriteret "cilësi" nga një ose më shumë nën-kritere dhe gjithashtu të formulohen secili nën-kriter duke përkrahur nivelet minimale dhe maksimale për secilin nga nën-kriteret. Secili nën-kriter paraqet ndarjen e kriterit përkatës. Pështja e caktuar për secilin nën-kriter (sipas rëndësisë, si zakonisht) do të jetë brenda kufijve të pikëve të parashikuara për vetë kriterin. Shuma e peshave të të gjithë nën-kritereve që i referohen të njëjtit kriter nuk duhet të kalojë peshën totale të caktuar për vetë kriterin.

9.10 Tenderuesi duhet, në bazë të përshkrimit në dokumentet e tenderit, të shohë se si do të përgatitë tenderin e tij për të arritur një rezultat të mirë dhe tenderi duhet të plotësohet me dokumentacion që shpjegon se si tenderuesi do të dorëzojë cilësinë dhe shërbimin e ofruar.

Shembull:

Afati maksimal i dorëzimit është 15 ditë nga data e lëshimit të urdhrin nga AK dhe afati minimal i dorëzimit është 5 ditë. Tenderuesi do të tenderojë në mes të 15 dhe 5 ditë. Nuk do të ketë pikë shtesë për tenderuesin që ofron dorëzimin për më pak se 5 ditë. Modeli i notimit mund të përcaktohet si në vijim:

< 5 ditë = 5 pikë

5-7 ditë = 4 pikë

7-10 ditë = 3 pikë

10-13 ditë = 2 pikë

15 ditë = 1 pikë

>15 ditë = 0 pikë.

9.11 Gjatë përcaktimit të kriterëve dhe rëndësisë së tyre relative, mund të merren parasysht:

- Kriteret duhet të përcaktohen rast pas rasti.
- Rëndësia relative duhet të pasqyrojë rëndësinë relative për autoritetin kontraktues.
- Kriteret duhet të lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe jo me aftësinë e operatorëve ekonomikë për të përmbushur kontratën.
- Kriteret duhet të përshtaten me specifikimet.
- Kriteret duhet të formulohen në mënyrë të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshme për operatorët ekonomik.
- Vetëm kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë mund të aplikohen.
- Kriteret duhet të përcaktohen në përputhje me LPP-në dhe parimet themelore të prokurimit.

9.12 **Parimet e përgjithshme që rregullojnë përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.**

Kriteret e vlerësimit duhet të përcaktohen nga Autoritetet Kontraktuese në mënyrë që të garantojnë respektimin e **parimeve të transparencës, mos-diskriminimit dhe trajtimit të barabartë. Për më tepër, duhet të sigurojnë një nivel të përshtatshëm konkurrence.**

Rrjedhimisht, ato duhet:

- **të rezultojnë si jo arbitrare.** Nën diskrecionin e AK-së në përcaktimin e tyre (siç përcaktohet nga Neni 52.4 i LPP), nuk duhet të kenë në asnjë rast **efektin e dhënies së një lirie të pakufizuar sipas zgjedhjes së autoritetit kontraktues.** Përkufizimi i tyre në fakt duhet të sigurojë mundësinë e konkurrencës efektive, të mos krijojë efekte deformuese dhe të mos lejojë kurrfarë avantazhi për një konkurrent, duke respektuar një tjetër.
- **të jenë të lidhura me lëndën e kontratës.** Kriteret e vlerësimit, në përputhje me nenin 52.2 të LPP-së, duhet të konsiderohen të lidhura me lëndën e kontratës **kur ato kanë të bëjnë me punët, furnizimet ose shërbimet** që do të ofrohen sipas asaj kontrate në çdo aspekt dhe në çdo fazë të ciklit të jetëgjatësisë së tyre, duke përfshirë faktorët e përfshirë në:
 - o procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose
 - o procesin specifik të një faze tjetër të ciklit të jetëgjatësisë së tyre, edhe kur faktorët e tillë nuk janë pjesë e substancës së tyre materiale.
- **të jenë objektive** në masën më të madhe të mundshme. Kriteret e vlerësimit (Neni 52.3 i LPP) janë objektive atëherë kur pasqyrojnë elementët e pranishëm në tregun përkatës dhe të përshtatshme për të vënë të gjithë konkurrentët e pranishëm në treg në pozitë për të shprehur një propozim. Rrjedhimisht, përkufizimi i tyre përfshin referencën ndaj specifikimeve që lejojnë që informacioni i ofruar nga ofertuesit të verifikohet në mënyrë efektive për të vlerësuar se sa mirë ofertat plotësojnë kriteret e dhënies së kontratës.
- **t'i referohen elementeve të kuantifikueshme.** Kriteret e vlerësimit do t'i referohen komponentëve të ofertës, të cilët janë të përshtatshëm për t'u shprehur në numra (Neni 52.5 i LPP), dhe kështu, objektivisht të krahasueshme dhe të ranguara.
- Të jenë jo-**diskriminuese.** Kjo përfshin që kriteret e vlerësimit nuk duhet të individualizohen ashtu që të paragjykojnë ose favorizojnë një konkurrent të caktuar të pranishëm në treg. Për të shmangur sa më shumë që është e mundur një rrezik të tillë dhe për të kufizuar lirinë e AK-ve në zgjedhjen e tyre, kriteret e identifikuar të vlerësimit duhet të jenë vetëm zakonisht të pranishme në tregun përkatës dhe mjaftueshëm të sakta në përkufizimin e tyre.
- **të identifikohen dhe përshkruhen qartë në dosjen e tenderit.** Kriteret e vlerësimit do të parashikohen në dokumentet e tenderit, dhe nuk lejohet ndryshimi apo zëvendësimi i asnjërës prej tyre pas publikimit të procedurës së tenderimit. Ato duhet të shprehen (së bashku me peshat dhe formulën e përdorur për dhënien e pikëve) në mënyrë të qartë dhe të saktë, në mënyrë që t'u

mundësohet OE-ve të dorëzojë oferta duke pasur njohuri të sakta për nevojat e AK-së dhe rregullat që duhet të zbatohen për vlerësimin e një tenderi. Vetëm në këtë mënyrë garantohet efektivisht parimi i trajtimit të barabartë dhe transparencës së plotë.

- **të mos i referohen ose të mbivendosen me kriteret e përzgjedhjes (Neni 52.4)**

9.13 Përdorimi i kriterit të dhënies tenderi i përgjegjshëm me “çmimin më të ulët”

Kriteri “*çmimi më i ulët*” mund të përdoret në rastet e mëposhtme:

- **Çmimi** është veçoria e vetme e rëndësishme e blerjes. Për AK-në është e rëndësishme vetëm ajo që duhet blerë nën kushte të paracaktuara dhe çmim përkatës, pa asnjë implikim sa i përket karakteristikave dhe elementeve të cilësisë.
- **Blerjet e standardizuara:** blerjet që nuk mund të modifikohen me kërkesë të autoritetit kontraktues për shkak të natyrës dhe/ose ciklit prodhues (p.sh. ujë, benzinë, energji elektrike, gaz natyror, softuer, etj.); ose furnizime, karakteristikat teknike të të cilave janë të paracaktuara saktësisht në standardet teknike (në nivel kombëtar, evropian ose ndërkombëtar) dhe për të cilat nuk ka nevojë të merren, gjatë procedurave të tenderimit, oferta të ndryshme për t'u krahasuar për nga cilësia.
- **Blerjet e përsëritura dhe kontratat me vlerë të ultë,** kur karakteristikat e prokurimit janë të tilla që imponojnë blerjen e mallrave/shërbimeve/punëve me kushte tashmë të njohura për autoritetin kontraktues ose kur, për kontratat me vlerë të kufizuar, avantazhet e pritshme, sa i përket cilësisë janë të kufizuara në lidhje me shpejtësinë e procedurës. Për shembull, të gjitha rastet kur AK përgatit projektin ekzekutiv dhe nuk kërkon konkurs për vetë projektin; ose blerjet ku AK-ja ka fituar një përvojë të madhe për shkak të përsëritshmërisë periodike të asaj blerjeje. Më në përgjithësi, në të gjitha ato raste përfitimet që rrjedhin nga konkurrenca për raportin më të mirë cilësi/çmim janë zero ose shumë të ulëta.

9.14 Përdorimi i kriterit të dhënies “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm”

- TEMF zakonisht përdoret për furnizime komplekse, shërbime dhe kontrata të punëve, ku ekzistojnë produkte / zgjidhje të ndryshme dhe të cilat nuk ndryshojnë vetëm në çmim.
- Përdorimi i TEMF nënkupton që autoriteti kontraktues është i gatshëm të paguajë më shumë para për të arritur një rezultat më të mirë cilësor.
- TEMF bazohet në metodologjinë e cila, duke përmirësuar komponentin tekniko-cilësor, krahas elementit ekonomik të shërbimit, punës ose furnizimit, garanton zgjedhjen e tenderit duke ofruar vlerën më të mirë për para.
- Termi “**vlerë për para**” tregon kombinimin optimal midis **koshtos** (si çmimi dhe kostot e jetëgjatësisë së mallrave, punëve ose shërbimeve) dhe **elementeve cilësore të tenderit** (aspektet

funkionale, teknike, mjedisore, estetike, sociale), në mënyrë që të plotësohen më mirë nevojat e AK-së.

Disa raste ku mund të konsiderohen të përshtatshme për përdorimin e **TEMF** janë si më poshtë.

- **Prokurimi i furnizimeve** - për kontratat e furnizimeve që përfshijnë instalime të rëndësishme dhe të specializuara të produktit dhe / ose mirëmbajtje dhe / ose aktivitete të trajnimit të përdoruesve, është e zakonshme që dhënia e kontratës të bëhet në bazë të kriterit të TEMF. Për këtë lloj kontrate, në fakt, cilësia është normalisht e një rëndësie të veçantë.
- **Prokurimi i punëve** - për punët e dizajnuara nga tenderuesi, përdoret shpesh kriteri i TEMF - it.
- **Prokurimi i shërbimeve** - për prokurimin e shërbimeve konsulente dhe përgjithësisht të shërbimeve intelektuale, cilësia është normalisht shumë e rëndësishme. Përvoja ka treguar se kur kërkojmë këtë lloj shërbimi, rezultatet më të mira në aspektin e vlerës më të mirë për para arrihen kur përdoret kriteri TEMF.

9.15 Përdorimi i kriterit të dhënies tenderi i përgjegjshëm me “çmimin më të ulët me poentim”**SHEMBULL:**

- Lënda e kontratës: Mirëmbajtja e veturave
- Kriteri për dhënien e kontratës: *Çmimi më i ulët me poentim*

Kategoritë	Pesha në bazë të rëndësisë	Çmimi i peshuar	Kompania A		Kompania B		Kompania C		
			Çmimi	Çmimi i peshuar	Çmimi	Çmimi i peshuar	Çmimi	Çmimi i peshuar	
1	Çmimi për servise të rregullta	60%	Çmimi x60%	€ 100,00	€ 60,00	€ 80,00	€ 48,00	€ 110,00	€ 66,00
2	Çmimi për mirëmbajtje dhe pjesë rezervë	20%	Çmimi x20%	€ 100,00	€ 20,00	€ 80,00	€ 16,00	€ 50,00	€ 10,00
3	Çmimi për riparime dhe Ngjyrosje	5%	Çmimi x 5%	€ 120,00	€ 6,00	€ 200,00	€ 10,00	€ 70,00	€ 3,50
4	Çmimi për pjesët e karroserisë	15%	Çmimi x15%	€ 100,00	€ 15,00	€ 150,00	€ 22,50	€ 120,00	€ 18,00
		100%							
Çmimi total (pa peshuar ne baze të rëndësisë dhe frekuences):				€ 420,00		€ 510,00		€ 350,00	
Çmimi total i peshuar – Kontrata me çmimin me të ulët:				101€		96.50€		97.50€	

- Fituesi në bazë të kriterit tenderi me çmimin më të ulët: **Kompania B.**
- Arsyeja është se, edhe pse shuma totale e çmimeve për njësi është me i ulëti tek kompania C, por Çmimi i Servisimeve të rregullta (artikulli Nr. 1), do të porositet në të shumtën e rasteve (60%) e që është më i shtrenjti në rastin e kompanisë C.
- Shuma totale e çmimeve për njësi është me i larti tek kompania B, megjithatë, artikulli qe nevojitet me se shpeshti (Nr. 1) është më i liri nga kjo kompani prandaj çmimi i përgjithshëm i poentuar është më i ulëti nga kjo Kompani. Fatura do të lëshohet në çdo rast në bazë të sasive reale dhe jo çmimeve të peshuara! Në këtë shembull vetëm kemi peshuar çmimet për njësi ne baze të rëndësisë se tyre!

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon Certifikata e regjistrimit të biznesit	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e TVSH	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon licenca	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Mund të kërkohen informata sqaruese	68

Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	68
Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Lista e çmimeve është plotësuar por nuk është nënshkruar (tenderët e dorëzuar ne forme fizike)	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
Lista e çmimeve nuk është plotësuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon Deklarata e themelimit të grupit	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon Deklarata nën Betim	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“specifikimit teknik” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	28

deklaratën ku deklarohet se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar)		
Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
Është kërkuar autorizimi origjinal por është dorëzuar autorizimi i skanuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	66

11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët

11.1 Në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

SHEMBULL 1

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	Kushti 1: është përmbushur kushti i parë sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 6 oferta		
2		1	2,021,514.20	
3		2	1,334,220.45	
4		3	2,151,997.25	
5		4	1,899,832.59	
6		5	2,494,303.84	
7		6	1,987,499.90	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	11,889,368.23	
9		Mesatarja (C8/6)	1,981,561.37	
10	Kushti 2: te gjitha ofertat nën këtë çmim përmbushin kushtin e dytë	pragu 30% (mesatarja /1.3)	1,524,277.98	ne këtë rast vetëm oferta 2 përmbushë kushtin e dytë prandaj vazhdohet me kushtin e tretë
11	Kushti 3: pragu 10% në mes ofertës me të lirë në krahasim me ofertën e dytë me të lirë	pragu 10% (oferta e dytë /1.1)	1,727,120.54	ne këtë rast oferta 2 përmbushë edhe kushtin e tretë

**UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR
PROKURIMIN PUBLIK**

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C11
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet

SHEMBULL 2

Nr.	Lot 2			
	A	B	C	D
1	Kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta	Pranuar 4 oferta		
2		1	2,684,598.09	
3		2	1,888,880.48	
4		3	1,878,488.51	
5		4	2,497,038.42	
6				
7				
8		Total (C2+C3+C4+C5)	8,949,005.50	
9		Mesatarja (C8/4)	2,237,251.38	
10	Kushti 2 - te gjitha ofertat nen këtë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	1,720,962.60	ne këtë rast asnjë oferte nuk përmbush kushtin e dyte prandaj NUK vazhdohet me kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta.
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Asnjë oferte nuk plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me pak se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C10

Konkludim	Asnjë oferte nuk mund te konsiderohet si oferte anormalisht e ulet sipas paragrafit 3.1 por AK mund te vazhdoj sipas paragrafit 3.2 te rregullores
-----------	---

12. Kontratat Publike Kornizë – çmime njësi – Shërbime/furnizime

12.1 Kurdo që Autoriteti Kontraktues ka për të dhënë një Kontratë publike - *çmime për njësi* – Shërbime/furnizime, Autoriteti Kontraktues do të luaj një rol aktiv në përcaktimin sa më të përafërt të vlerës së parashikuar të kontratës, dhe peshën (poentimin) e dhënë sipas rëndësisë së çdo kategorie të shërbimeve apo furnizimeve.

12.2 Në rast të **Kontratave Publike Kornizë – Shërbime/furnizime** - Çmimi për njësi i peshuar (poentuar) sipas kategorive, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që në Dosje të Tenderit të specifikoj normën e peshimit (poentimit) për çdo kategori.

12.3 Numri i kategorive dhe norma e peshimit për kategori, varet nga lloji i shërbimit/furnizimit (në praktikën më të mira nuk duhet të jetë më pak se tri kategori), por norma e përqindjes së peshimit (poentimit) e të gjitha kategorive së bashku, nuk lejohet të jete me shume së 100%.

12.4 Totali i çmimit për njësi i peshuar për të gjitha kategoritë duhet të shënohet në Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve dhe Raportin e Vlerësimit të Tenderëve dhe merret për bazë gjatë vlerësimit të tenderëve.

12.5 Duke pasur parasysh faktin së peshimi i kategorive duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që edhe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në Dosjen e Tenderit.

12.6 Për qëllim të realizimit të kontratës konform legjislacionit të prokurimit publik dhe definimit të vlerave të kategorive që lejohen të shpenzohen, Autoritetit Kontraktues, para nënshkrimit të Kontratës Publike Kornize – Shërbim/furnizime me çmime për njësi, duke u bazuar në tenderin e OE fitues, do të hartojë tabelën në të cilën do të specifikojë të gjitha kategoritë e shërbimeve/furnizimeve, si dhe vlerën monetare për secilën kategori deri në të cilën vlerë lejohet të shpenzohet gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

12.7 Gjatë realizimit të Kontratës Publike Kornize – Shërbime apo furnizime, Ofruesi i Shërbimeve/furnizimeve, faturimin e bene duke u bazuar në shërbimet/furnizimet e kryera dhe çmimet për njësi të shërbimeve/furnizimeve të kontratës (jo çmimeve të peshuara), por nuk lejohet të kaloj vlerën sipas kategorive dhe vlerën totale të parashikuar të kontratës.

**UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR
PROKURIMIN PUBLIK**

Shembull:

Tabela e kalkulimit të çmimit për Kontratën Publike Kornizë - Shërbime/furnizime - Çmimi për njësi i peshuar (poentuar), sipas kategorive, kur vlera e parashikuar e kontratës është 100,000.00 €						
Nr.	Kategoria I	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH	Pesha (poentomi) e çmimit për kategori	Vlera totale e cila lejohet të shpenzohet për Kategorinë I
1	A	Copë	1	125.00		
2	B	Copë	1	50.00		
3	C	Copë	1	25.00		
4	Ç	Copë	1	10.00		
5	D	Copë	1	130.00		
6	DH	Copë	1	15.00		
7	E	litër	1	60.00		
8	Ë	Copë	1	80.00		
9	F	Cope	1	220.00		
10	G	Cope	1	40.00		
Totali i çmimeve për njësi dhe totali i çmimit total të peshuar (1 deri 10)				755.00	60%	60,000.00
Nr.	Kategoria II	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Pesha e çmimit për kategori	Vlera totale e cila lejohet të shpenzohet për Kategorinë II
1	A	Copë	1	120.00		
2	B	Copë	1	40.00		
3	C	Copë	1	60.00		
4	Ç	Copë	1	30.00		
5	D	Copë	1	25.00		
6	DH	Copë	1	160.00		
7	E	Copë	1	240.00		
Totali i çmimeve për njësi dhe totali i çmimit total të peshuar (1 deri 7)				675.00	30%	30,000.00
Nr.	Kategoria II	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH	Pesha e çmimit për kategori	Vlera totale e cila lejohet të shpenzohet për Kategorinë III
1	A	Copë	1	400.00		
2	B	Copë	1	650.00		
3	C	Copë	1	250.00		
4	Ç	Copë	1	300.00		
5	D	Copë	1	120.00		
Totali i çmimeve për njësi i peshuar (1 deri 5)					172.00	10,000.00
Totali i çmimit për njësi i peshuar për kategoritë (I+II+III), që shënohet në						827.50

UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR
PROKURIMIN PUBLIK

Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve dhe Raportin e Vlerësimit të Tenderëve:

Shënim:

Kalkulimi i çmimit total për njësi dhe çmimit totale të peshuar sipas kategorive është si në vijim:

Kategoria I: Çmimi total për njësi është mbledhja e të gjitha çmimeve (1 deri 10), e që është: 755.00 X 60 % pesha e kategorisë -I-, e barabarte me çmimin total për njësi i peshuar = **453.00;**

Kategoria II: Çmimi total për njësi është mbledhja e të gjitha çmimeve (1 deri 7), e që është: 675.00 X 30 % pesha e kategorisë -II-, e barabarte me çmimin total për njësi i peshuar = **202.50;**

Kategoria III: Çmimi total për njësi është mbledhja e të gjitha çmimeve (1 deri 5), e që është: 1,720.00 X 10 % pesha e kategorisë -III-, e barabarte me çmimin total për njësi i peshuar = **172.00;**

Totali i çmimit të peshuar për njësi i cili duhet të shënohet në Procesverbalin e Hapjes së Ofertave dhe Raportin e Vlerësimit të Ofertave, është: 453.00 + 202.50 + 172.00 = **827.50;**

Kalkulimi i vlerës totale e cila lejohet të shpenzohet për kategori është si në vijim:

Kategoria I: Vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 x 60 % pesha e kategorisë I = **60,000.00;**

Kategoria II: Vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 x 30 % pesha e kategorisë II = **30,000.00;**

Kategoria III: Vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 x 10 % pesha e kategorisë III = **10,000.00;**

2. Hyrja në fuqi

Udhëzuesi Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 hynë në fuqi në datën e nënshkrimit.


Datë: _____

Osman Vishaj

Kryetar i KRPP-së

**Aneksi 1
NUMRI I PROKURIMIT**

Në të gjithë formularët numri i identifikimit të prokurimit formohet si në vijim:



UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR
PROKURIMIN PUBLIK

2. Hyrja në fuqi

Udhëzuesi Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 hynë në fuqi në datën e nënshkrimit.

Datë: 20/12/2024

Osman Visha

Kryetar i KRPP-së

